

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK) me numër fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.20, dhe nenit 29, paragrafi 7 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me numër protokoli 8648/24, dhe në mbështetje të nenit 7, paragrafit 2 të RREGULLORES PËR LARTËSINË DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË INXHINIERIT TË LICENCUAR, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 06.05.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet shpallja publike për shprehje interesi nga kompanitë e sigurimeve për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së _____
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së _____
3. **Kadri Morina**
Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
4. **Afrim Demiri**
Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
5. **Nebi Pllana**
Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
6. **Bujar Jupaj**
Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____
7. **Sami Kolgeci**
Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së _____

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

SHPALLJE PUBLIKE

Shprehje Interesi nga Kompanitë e Sigurimeve për Sigurimin e Përgjegjësisë Profesionale të Inxhinierëve të Licencuar

Në mbështetje të: Nenit 7 të Rregullores për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar; Nenit 8 të Statutit të OIRK-së; Ligjit nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; dhe Vendimit Nr. 22-BD/2025 të Bordit Drejtues të OIRK-së.

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) fton të gjitha kompanitë e sigurimeve të licencuara në Republikën e Kosovës që të shprehin interesin për bashkëpunim për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar.

Qëllimi i shpalljes: Qëllimi i kësaj ftese është përzgjedhja e një kompanie të sigurimeve për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi me OIRK-në, për ofrimin e sigurimit të detyrueshëm profesional për anëtarët e licencuar të Odës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të OIRK-së.

Të dhëna të përgjithshme: OIRK është organizatë profesionale publike jofitimprurëse e cila vepron me autorizim ligjor në rregullimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të inxhinierit në fushën e ndërtimit, duke ruajtur shëndetin, sigurinë publike dhe mjedisin.

Me rreth 910 anëtarë të licencuar aktualisht, dhe me një numër në rritje për shkak të procesit të vazhdueshëm të licencimit, OIRK është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore që parashohin mbulimin e përgjegjësisë profesionale për secilin inxhinier të licencuar.

Ky sigurim, sipas Rregullores për Lartësinë dhe Mënyrën e Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale të Inxhinierit të Licencuar, është i detyrueshëm sipas **Nenin 7** dhe realizohet përmes marrëveshjes që Oda lidh me një kompani të licencuar të sigurimeve.

Në përputhje me **Nenin 5** të kësaj rregulloreje, shumat minimale të mbulimit të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për një inxhinier të licencuar nuk mund të jetë më e vogël se njëzet mijë (20.000) euro.

Kjo shpallje synon të sigurojë një proces transparent, të hapur dhe konkurrues për përzgjedhjen e ofertave më të përshtatshme dhe me kushte sa më të favorshme për anëtarët e Odës.

Dokumentet dhe të dhënat që kërkohen: Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë:

1. Licencën për operim në Kosovë;
2. Informata të përgjithshme për kompaninë dhe përvojën e saj;
3. Përshkrimin e mbulimit të sigurimit për përgjegjësi profesionale;
4. Ofertën financiare për primin vjetor të sigurimit;
5. Politikat për franchising (nëse aplikohen), dhe sqarim të kushteve të mbulimit;
6. Afatet dhe procedurat për trajtimin dhe pagesën e dëmeve;

7. Opsione shitesë për mbulim ose kushte të veçanta për anëtarët e OIRK-së;
8. Përvoja të mëhershme në bashkëpunim me organizata profesionale ose institucione publike (nëse ka);
9. Mundësi për mbështetje teknike për anëtarët gjatë aplikimit për policë sigurimi.

Afati dhe mënyra e aplikimit: Dokumentet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në email adresën: odaeinxhinierëve@gmail.com. Afati i fundit për pranimin e dokumentacionit: datë 16 Maj 2025 deri në ora 16:00. Dokumentet duhet të jenë në format PDF, të nënshkruara dhe të shoqëruara me të dhëna kontakti.

Përzgjedhja dhe transparencja: Komisioni përkatës i OIRK-së do të shqyrtojë ofertat dhe, nëse është e nevojshme, do të ftojë kompanitë për diskutime shitesë. Përzgjedhja do të bëhet mbi bazën e përputhshmërisë ligjore, cilësisë së mbulimit dhe përfitimeve për anëtarësinë.

OIRK garanton një proces të drejtë, profesional dhe të hapur për të gjitha kompanitë konkurruese.

Për informacione shitesë, ju lutemi kontaktoni në email adresën: odaeinxhinierëve@gmail.com

Bordi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës

Datë: 06.05.2025